Të Hyrat dhe Shpenzimet buxhetore, Janar-Shtator 2026

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave (MF), gjatë periudhës Janar - Shtator 2026, të hyrat buxhetore kanë arritur në 2,652.3 milionë euro, duke shënuar rritje prej 6.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Në strukturën e të hyrave (në %), Të hyrat tatimore përbëjnë pjesën më të madhe me 90.4% (ose 2,398.9 mln €). Struktura e të hyrave tatimore vazhdon të dominohet nga tatimet indirekte (tvsh, akciza dhe dogana), të cilat përbëjnë pjesën dërrmuese të hyrave, gjë që pasqyron mbështetjen e lartë të buxhetit te konsumi dhe importi.

Në anën e shpenzimeve, Shpenzimet buxhetore në nëntëmujorin e vitit 2026 arrijnë në 2,591.9 milionë euro, që paraqet një rritje prej 14.9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, kjo paraqet rritje më të lartë krahasuar me periudhat e njeta te viteve paraprake. Rritja mbështetet kryesisht nga shpenzimet rrjedhëse Paga dhe shtesa me rritje prej 16.0% dhe Subvencione dhe transfere rritje prej 26.8%, si kategori dominuese në totalin e shpenzimeve buxhetore.
Tabela në vijim te hyrave dhe shpenzimeve buxhetore periudhës Janar-Shtator 2022-2026, dhe Progresi, ekzekutimin në përqindje për vitin aktual krahasuar me Buxhetin 2026 (SIMFK).

Tabela 1. Të Hyra buxhetore dhe Shpenzime buxhetore për Janar - Shtator 2022-2026

Përshkrimi *(në milion Euro)*	I-IX/2022	I-IX/2023	I-IX/2024	I-IX/2025	I-IX/2026	Ndryshimin 2026/2025	Realizimi /Buxheti (në%)
1.1 Të HYRAT BUXHETORE	**1,850.4**	**2,114.7**	**2,264.5**	**2,488.0**	**2,652.3**	**6.6%**	72.7%
1.1.1 Të hyrat tatimore	1,643.2	1,839.3	1,999.8	2,206.5	2,398.9	8.7%	73.6%
Tatimet Direkte	313.9	376.1	390.8	425.8	490.0	15.1%	75.1%
Tatimet Indirekte	1,377.5	1,506.7	1,669.1	1,836.5	1,970.2	7.3%	72.8%
Kthimet Tatimore	-48.2	-43.5	-60.0	-55.8	-61.4	10.1%	59.6%
1.1.2 Të hyrat jo-tatimore	189.4	197.3	256.5	255.5	245.1	-4.1%	66.3%
1.1.3 Mbështetje buxhetore dhe grantet	10.3	67.5	0.0	14.4	0.01		0.1%
1.2 Pranimet nga GPD	7.6	10.5	8.2	11.7	8.3	-28.7%	0.3%
2.1 SHPENZIMET BUXHETORE	**1,585.1**	**1,826.3**	**2,000.2**	**2,256.7**	**2,591.9**	**14.9%**	64.8%
2.1.1 Shpenzimet rrjedhëse	1,394.5	1,523.3	1,629.8	1,821.5	2,168.0	19.0%	74.4%
Paga dhe shtesa	477.5	566.1	639.9	673.8	781.5	16.0%	79.7%
Mallra dhe shërbime	200.5	238.8	262.3	309.3	327.2	5.8%	61.4%
Shpenzime komunale	17.9	18.3	19.6	24.2	26.8	10.9%	73.2%
Subvencione dhe transfere	698.5	700.1	708.1	814.2	1,032.5	26.8%	76.4%
2.1.2 Shpenzimet kapitale	158.1	263.8	324.7	389.2	376.8	-3.2%	36.9%
2.1.3 Shpenz. e Interesit për borxh publik	27.2	32.9	32.3	37.8	38.7	2.5%	78.2%
2.2 Pagesat nga GPD	5.3	6.3	13.4	8.3	8.3	0.1%	44.7%


Burimi: Ministria e Financave (MF), Raporti Seritë Fiskale Mujore deri shtator 2026
https://mf.rks-gov.net/Thesari/Page/973

Shpenzimet buxhetore gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej 2,591.9 milionë euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 64.8% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar (Buxheti 2026 në SIMFK në vlerë prej 3,984.3 milionë euro) për këtë kategori.

Nëse analizojmë sipas strukturës së shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2026 (në %), peshën kryesore e mbajnë shpenzimet rrjedhëse:

- ✓ Subvencione dhe transfere, përbëjnë pjesën më të madhe me 39.8% (ose 1,032.5 mln €),
- ✓ Paga dhe shtesa, renditen të dytat me 30.2% (ose 781.5 mln €),
- ✓ Shpenzimet kapitale, përbëjnë 14.5% (ose 376.8 mln €), të gjithsej shpenzimeve në periudhën nëntëmujore 2026, ndërsa
- ✓ Mallra dhe shërbime, përfshijnë 12.6% të buxhetit dhe Të tjera si Shpenzimet e interesit për borxh publik (1.5%) dhe shpenzimet komunale (1.0%).


Figura 1. Shpenzimet buxhetore, Buxhetin 2026 në (SIMFK), Realizimin Janar - Shtator 2026 në milionë euro, progresi i ekzekutimit në përqindje për kategori të shpenzimeve.



Burimi: Ministria e Financave (MF), Raporti Seritë Fiskale Mujore deri shtator 2026
https://mf.rks-gov.net/Thesari/Page/973
(shenim 1) te shtylla Shpenzimet rrjedhëse(Buxheti 2026 SIMFK) janë përfshirë 10.6 milionë euro,nga zëri Rezerva
(shenim 2) te pozicioni Gjithsej Pagesa buxhetor nuk janë përfshirë Pagesat 8.3 milionë euro nga GDP.

Nga Figura 1 vërehet një shpërndarje e pabarabartë e performancës së ekzekutimit të shpenzimeve. Derisa kategoritë e shpenzimeve operative dhe administrative si Paga dhe shtesa (79.7%) dhe Subvencione dhe transfere (76.4%) shfaqin shkallë të lartë të ekzekutimit në nëntëmujorin e vitit 2026, realizimi i Shpenzimeve kapitale me vetëm 36.9% tregon një ngadalësim të theksuar në fillimin dhe zbatimin e projekteve të reja zhvillimore, gjë që kërkon vëmendje të shtuar dhe përshpejtim të procedurave gjatë tremujorin e fundit të vitit.

Figura 2. Shpenzimet Kapitale Janar-Shtator sipas viteve 2022-2026 në milionë euro dhe rritje në % (v-m-v).




Burimi: Ministria e Financave, (MF),

Nga Figura 2 vërehen ndryshime ku shpenzimet kapitale shënuan një rritje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme vjetore gjatë periudhës 2022-2025 (duke u rritur nga 158.1 milionë euro në 389.2 milionë euro), derisa ekzekutimi i shpenzimeve deri Shtator te vitit 2026 shënon rënien vjetore prej -3.2% (duke rënë në 376.8 milionë euro). Kjo prirje negative pasqyron një ngadalësim të ritmit të investimeve publike, duke rrezikuar potencialisht stimulin ekonomik afatgjatë që vjen nga projektet e infrastrukturës dhe zhvillimit.

Nëse analizojmë sipas niveleve (qeveria qendrore apo niveli lokal) pjesën kryesore e mbajnë shpenzimet në nivelin qendrore me 1,926.5 milionë euro apo rreth 74.6%, niveli lokal me 657.1 milionë euro apo rreth 25.4 % nga gjithsej shpenzimet për periudhën Janar-Shtator 2026, sipas kategorive:


- ✓ te Paga dhe shtesa, niveli qendror merr pjesë me 55.7%, niveli lokal me 44.3% nga gjithsej shpenzimet për paga dhe shtesa,
- ✓ te Mallra dhe shërbime, niveli qendror merr pjesë me 62.7%, niveli lokal me 37.3% nga gjithsej shpenzimet te kjo kategori,
- ✓ te Subvencione dhe transfere, niveli qendror merr pjesë me 97.4%, niveli lokal vetëm me 2.6% nga gjithsej subvencione e transfer,
- ✓ te Shpenzimet kapitale nga gjithsej 376.8 milionë euro, në nivelin qendrore 225.5 milionë euro apo rreth 59.8%, niveli lokal me 151.3 milionë euro apo rreth 40.2 % nga gjithsej shpenzimet kapitale.

Figura 3. Shpenzimet në Niveli qendror dhe Lokal sipas kategorive, janar - shtator 2026 në milionë euro.



Burimi: Ministria e Financave (MF)

Figura 4. Shpenzimet sipas kategorive në %, në raport me Gjithsej shpenzimet periudhën Janar-Shtator 2022-2026.



Burimi: Ministria e Financave (MF)

Nëse analizojmë trendet në Figurat 3 dhe 4, për periudhën Janar-Shtator 2022-2026 vërehet një ndryshim i dukshëm i strukturës së shpenzimeve buxhetore.

Ky ndryshim strukturor i shpenzimeve vë në dukje një rrezik të lartë të transferimit të resurseve buxhetore nga investimet produktive drejt skemave konsumi. Subvencionet dhe transferet kanë rikthyer dominancën e tyre si për nga dinamika e ekzekutimit ashtu e vëllimi duke zënë 39.8% të totalit të shpenzimeve në vitin 2026 (një rritje e ndjeshme nga 26.8% sa ishin në vitin 2025), kjo rritje vjen drejtpërdrejt në dëm të Shpenzimeve kapitale, pesha e të cilave ka rënë në rreth 14.5% dhe kanë nivelin më të ulët të ekzekutimit për periudhen nëntëmujore, vetëm rreth 1/3 e planit me buxhetin vjetor.

Gjithashtu vlenë theksohet se përqendrimi pothuajse i plotë i subvencioneve dhe transfereve në nivelin qendror (97.4%) tregon se skemat e mbështetjes financiare menaxhohen pothuajse tërësisht nga qeverisja qendrore, duke lënë nivelin lokal me hapësirë mjaft të kufizuar për ndërhyrje direkte sociale e ekonomike.

Nga perspektiva e politikave makroekonomike, kjo zhvendosje nxit konsumin afatshkurtër, por redukton aftësinë e vendit për të ndërtuar kapacitete të qëndrueshme prodhuese dhe rrit rrezikun e presioneve inflacioniste.

Për të siguruar qëndrueshmëri fiskale dhe rritje të qëndrueshme ekonomike, rekomandohet riorientimi i politikave buxhetore nga konsumi afatshkurtër drejt përshpejtimit të investimeve kapitale me ndikim shumëfishues dhe afatëgjatë për sektorin privat.